



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 275/3 prot.

Tiranë, më 28.1.2019

VENDIM

Nr. 4, datë 28.1.2019

PËR

**MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN E SPECIALIZIMEVE
AFATGJATA, TË CIKLIT TË TRETË, NË FUSHËN E MJEKËSISË, NË
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË**

Në bazë të nenit 38, pika 1, germa d) e vijues të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 15 e vijues të Statutit të UMT-së, i ndryshuar, si dhe propozimit të Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Senati Akademik, pasi shqyrtoi materialin e përgatitur për saktësimin/ndryshimin e disa dispozitave të Rregullores së Specializimeve Afatgjata, të Ciklit të tretë, në Fushën e Mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

- I. Në Rregulloren e Specializimeve Afatgjata, të Ciklit të Tretë, në Fushën e Mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, e ndryshuar, miratuar me Vendimin nr.88, datë 16.11.2016 të Senatit Akademik të UMT-së, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 1. Kudo emërtimet Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve të zëvendësohen përkatësisht me ministria përgjegjëse për shëndetësinë, ministria përgjegjëse për arsimin, Qendra e Shërbimeve Arsimore.
 2. Në nenin 13, pika b, pas *Personel akademik me kohë të pjesshme*, shtohet: Mbikëqyrës klinik
 3. Në nenin 18, pas (AJMHS) të shtohet: *ose në revistën shkencore të fakultetit përkatës*
 4. Në nenin 20, pika 4, në fund të fjalisë shtohet: *ose që kanë jo më pak se dy muaj të çregjistruar nga një program specializimi afatgjatë nga data e parë e aplikimit të programit aktual.*
 5. Në nenin 29, pika c bëhet:
 - c) Anëtarët e komisionit japin vlerësimin e aplikantëve individualisht nga 0 (zero) deri në 10 (dhjetë) pikë me votim të fshehtë. Rezultatet mblidhen dhe i përcillen brenda ditës dekanit të fakultetit përkatës.

6. Në nenin 31, pika a) bëhet si më poshtë:
 - a) të jenë të pajisur me dokument identiteti (kartë identiteti ose pasaportë) dhe me një fotokopje të saj, si dhe të jenë të pajisur me mandat-pagesë për tarifën e testit të informatizuar për llogari të QSHA-së.
 7. Në nenin 38, shtohet: Kandidatët që kanë grumbulluar jo më pak se 380 pikë nga numri i pikëve totale të konvertuara (maksimumi 1000 pikë), kualifikohen për procesin e përzgjedhjes së programit të specializimit sipas sistemit të meritës.
 8. Në nenin 39, shtohet: Formula e përlllogaritjes së pikëve të mesatares së ponderuar është: $(Nmp-5)*60$
 9. Në nenin 45, në paragrafin e parë hiqet togfjalëshi *...përfshirë edhe rrethin përkatës*; në paragrafin e dytë hiqet togfjalëshi *...dhe rrethit*; paragrafi i tretë bëhet si më poshtë: Kandidati përfitues i kuotave të mbuluara nga ministria përkatëse, duhet të paraqesë kontratën e nënshkruar me ministrinë përkatëse, jo më vonë se 2 (dy) javë nga data e regjistrimit.
 10. Neni 46, bëhet:

Procesverbali me rezultatin definitiv të fituesve sipas kuotave të programeve të studimit firmoset nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit dhe aplikanti dhe përcillet në Rektorat.
 11. Neni 47, pika c bëhet:
 - c) Kandidatët që do të regjistrohen në kuadër të kuotave të transferimit duhet të dorëzojnë dhe dokumentin e çregjistrimit nga programi i specializimit nga ku transferohen. Në rastet e transferimit nga programe specializuese jashtë vendit, në pamundësi të depozitimit të vërtetimit të çregjistrimit brenda afateve të parashikuara për regjistrim, kandidati regjistrohet me rezervë deri në depozitim e vërtetimit përkatës. Nëse kandidati nuk e depoziton dokumentin e çregjistrimit brenda një muaji nga data e shpalljes së fituesve, Fakulteti çregjiston kandidatin dhe mund të vijojë me regjistrimin eventual të kandidatit konkurrues vijues në listën përkatëse.
 12. Neni 69, pika 1, bëhet: Sigurim Shëndeti për Specializantët: mbrojtje deri në 1,000,000 lekë,
- II. Rregullorja e përditësuar e Specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, publikohet në faqen zyrtare të UMT-së dhe të fakulteteve përkatëse.
 - III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe u përcillet për zbatim fakulteteve përkatëse të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, dhe për njohje ministrive përkatëse.

KRYETARI
ARBEN GJATA

